



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 174, datë 11.09.2019

PËR

**PËRJASHTIMIN NGA KANDIDIMI PËR KOMANDIM PRANË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR TË GJYQTARES IRIDA KACERJA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 53 pika 7 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimin nr. 104 datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, në kërkesën për komandim të gjyqtares Irida Kacerja, si dhe në “Opinionin mbi kandidatët që kanë aplikuar për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e gjyqtares Irida Kacerja nga kandidimi për komandim në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për shkak të ekzistencës së një kriteri ndalues komandimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR